

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, dorëzuar përmes përfaqësuesit të autorizuar Ognjen Trajkovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 16.10.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi KDS-NET SHPK Vršac, me seli të regjistruar në rrugën Sime Gvozdenova 33, 26 300 Vršac, Republika e Serbisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 18.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga ana e Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, me të cilin Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi KDS-NET SHPK Vršac, me seli të regjistruar në rrugën Sime Gvozdenova 33, 26 300 Vršac, Republika e Serbisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, dhe shtojcave të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime kabllore dhe kryesisht shërbime

të telefonisë fikse dhe mobile, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

"Telekom Srbija" shoqëri aksionare Beograd ka një subjekt të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ai është:

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, e regjistruar për veprimtari: telekomunikime me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: rrjet publik radio-komunikues, qasje të gjerë në internet, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike publikisht të qasshme në rrjetin publik të komunikimeve mobile, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelit.

Subjekt i lidhur i MTEL SHPKNJP Shkup¹ është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBIL SHPKNJP Shkup. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBIL SHPKNJP Shkup vepron në tregun për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile (shërbim prepaid) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj final shërbim mobil postpejd. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBIL SHPKNJP Shkup është operator i rrjetit virtual mobil (ORRVM) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming të zërit, SMS dhe internetit.

Gjithashtu, subjekt i lidhur i "Telekom Srbija" shoqëri aksionare Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, e regjistruar për veprimtari telekomunikime satelitore.

KDS-NET SHPK Vršac është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, në momentin e parashtrimit të Njoftimit, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbime interneti, shërbime të distribuimit të përmbajtjes mediatike.

KDS-NET SHPK Vršac nuk ka subjekte juridike të lidhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

¹ Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me aktvendimin nr. 08-31/2023 të datës 22.03.2023 e miratoi përqendrimin me të cilin MTEL SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rrugën Maksim Gorki nr. 11-1/kati 3, 1000 Shkup, do të fitojë kontroll mbi shoqërinë NEOTEL SHPK Shkup, me seli në bulevardin Kuzman Josifovski-Pitu nr. 15, 1000 Shkup.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ